



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 tetor 2016
Nr. ref.:RK981/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KO94/16

Parashtrues

Slavko Simić dhe 10 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, nr. 05/L-010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: z. Slavko Simić, znj. Jelena Bontić, z. Saša Milosavljević, znj. Milka Vuletić, znj. Jasmina Živković, z. Slobodan Petrović, z. Bojan Mitić, znj. Milena Milićević, z. Srđan Popović, z. Nenad Rašić dhe z. Adem Hodža (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, nr. 05/L-010 (në tekstin e mëtejme: Ligji për AKVP-në), përkitazi me procedurën e ndjekur për miratimin e tij, më 9 qershor 2016, në Kuvendin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për AKVP-në, për të cilin parashtruesit pretendojnë se është nxjerrë në shkelje të nenit 81 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), që të vendosë masë të përkohshme për të pezulluar zbatimin e ligjit në fjalë, derisa kjo Gjykatë të vendosë përfundimisht për kërkesën.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113, paragrafi 5, i Kushtetutës, në nenet 27, 42 dhe 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatë

6. Më 17 qershor 2016, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
7. Më 17 qershor 2016, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KO94/16, caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues (anëtar) dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (anëtare).
8. Më 27 qershor 2016, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, për kërkesën u njoftuan Presidenti i Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Avokati i Popullit, të cilëve iu dërgua nga një kopje e kërkesës.
9. Më 29 qershor 2016, Kuvendi dorëzoi në Gjykatë dokumentacionin relevant përkitazi me Ligjin për AKKVP-në.
10. Ndërmjet datave 27 qershor dhe 1 korrik 2016, u zhvilluan disa komunikime ndërmjet Gjykatës dhe Presidencës së Republikës së Kosovës lidhur me hapat që duhej ndërmarrë për shpalljen dhe për hyrjen në fuqi të Ligjit.
11. Më 6 korrik 2016, deputetja e Kuvendit, znj. Albulena Haxhiu, në emër të Grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje (në tekstin e mëtejme: Grupi parlamentar i LVV-së), dorëzoi në Gjykatë komentet e këtij grupi mbi pretendimet e parashtruesve të kërkesës.

12. Më 11 korrik 2016, parashtruesit dorëzuan në Gjykatë dokumentacion shtesë lidhur me kërkesën. Po ashtu, parashtruesit kërkuan që të kenë qasje në *“të gjitha informacionet dhe argumentet që janë paraqitur në Gjykatë lidhur me rastin, si dhe të shtyhet për 15 ditë afati për vendosje të rastit, me qëllim që parashtruesit të kenë mundësi të analizimit të informacioneve shtesë lidhur me rastin”*.
13. Më 12 korrik 2016, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KO94/16, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova anëtare të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili më 9 shtator 2016 ka dhënë dorëheqje nga pozita e gjyqtarit të Gjykatës. Sipas moshës, kryesues i Kolegjit shqyrtues u caktua gjyqtari Almiro Rodrigues.
14. Më 15 korrik 2016, Gjykata njoftoi parashtruesit lidhur me komentet e dorëzuara nga Grupi parlamentar i LVV-së, duke u dhënë parashtruesve afat prej një jave për të dorëzuar komente shtesë.
15. Më 29 korrik 2016, parashtruesit dorëzuan komente shtesë lidhur me argumentet e Grupit parlamentar të LVV-së. Megjithatë, komentet shtesë të parashtruesve u dorëzuan jashtë afatit të përcaktuar nga Gjykata dhe për këtë, në përputhje me Rregulloren e punës së Gjykatës dhe sipas praktikave të Gjykatës, ato nuk mund të jenë pjesë e shkresave të lëndës (sipas Rregullores së punës së Gjykatës, afati shtatë ditor skadoi më 22 korrik 2016).
16. Më 13 shtator 2016, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, që ta deklarojë kërkesën e parashtruesve të papranueshme si qartazi të pabazuar, si dhe ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

17. Më 5 shkurt 2015, Qeveria (Vendimi nr. 01/12) aprovoi Projektligjin për AKKVP-në.
18. Më 24 mars 2015, Komisioni për legjislacion i Kuvendit e shqyrtoi Projektligjin për AKKVP-në dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë rekomandimin për shqyrtim të mëtutjeshëm dhe për miratim.
19. Më 7 prill 2015, Kuvendi votoi dhe e miratoi, në parim, projektligjin në fjalë dhe rezultati i votimit ishte si në vijim: për ishin 50 deputetë, kundër 25 deputetë, abstenuan 3 deputetë. Në këtë datë, Kuvendi nxori Vendimin nr. 05-V-38, me të cilin ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtonin Projektligjin brenda 2 (dy) muajsh nga shqyrtimi i parë dhe më pas t’ia paraqesin Kuvendit raportet finale dhe rekomandimet.
20. Më 19 prill 2016, Komisioni për Legjislacion paraqiti raportin me propozime dhe rekomandime. Më 26 prill 2016, Komisioni për Integritet Evropian paraqiti

raportin me rekomandime, ndërsa, më 27 prill 2016, raporti me rekomandime u paraqit edhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

21. Më 10 maj 2016, Komisioni për legjislacion, si komision funksional, me shumicë votash, e miratoi raportin nr. 05/2045/L-010 për Projektligjin për AKKVP-në me amendamentet e propozuara. Ndërsa, më 16 maj 2016, ky komision ua paraqiti deputetëve dhe Kryesisë së Kuvendit raportin përfundimtar.
22. Më 25 maj 2016, Kuvendi mbajti seancën plenare të radhës, në të cilën shqyrtoi Projektligjin për AKKVP-në dhe i votoi disa amendamente të propozuara. Por, në mungesë të kuorumit për vendimmarrje përfundimtare, mbeti pa u miratuar një amendament, si dhe teksti në tërësi i Projektligjit. Procedimi i mëtejshëm i Projektligjit për AKKVP-në u shty për seancën e radhës (Shih, transkriptin e Kuvendit, mbledhja plenare e 25 majit 2015, faqja 21).
23. Më 8 qershor 2016, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve e shqyrtoi Projektligjin për AKKVP-në dhe mori vendim për të mos e mbështetur Projektligjin për procedim të mëtutjeshëm dhe për miratim, me rekomandimin për Kuvendin që shqyrtimi i Projektligjit të shtyhet ose të tërhiqet nga procedura e mëtutjeshme. Sipas shkresave të lëndës rezultoi se përkitazi me këtë fakt Kuvendi u njoftua me shkrim më 28 qershor 2016.
24. Më 9 qershor 2016, Kuvendi mbajti seancën plenare ku, ndër të tjera, në rend të ditës ishte paraparë shqyrtimi i dytë i Projektligjit për AKKVP-në. Sipas procesverbalit të Kuvendit, P-066, të 9 qershorit 2016, Projektligji për AKKVP-në është miratuar si në vijim: për ish-in 51 deputetë, kundër 18 dhe abstenuan 7 deputetë.

Argumentet e paraqitura nga parashtuesit e kërkesës

25. Në kërkesën e tyre, parashtuesit pretendojnë se Ligji për AKKVP-në është me rëndësi vitale për interesat e komunitetit serb në Kosovë (dhe personave të zhvendosur) dhe, rrjedhimisht, ky ligj është dashur të miratohet sipas procedurës së parashikuar në nenin 81 të Kushtetutës.
26. Sipas parashtuesve:

“Gjatë miratimit të Ligjit nuk është respektuar procedura e parashikuar me nenin 81 të Kushtetutës së Kosovës, i cili përcakton se ligjet që janë me interes vital për komunitete duhet të miratohen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve të Kuvendit të cilët janë të pranishëm dhe me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë.

Duke marrë parasysh se Ligji në fjalë është miratuar sipas procedurës së zakonshme (e cila kërkon vetëm shumicën e thjeshtë të deputetëve të pranishëm të Kuvendit), atëherë për shkak të shkëlqes së dispozitës së cekur të nenit 81 të Kushtetutës, Ligji i miratuar është jokushtetues”.

Zgjidhja e kërkuar nga parashtresit e kërkesës

27. Parashtresit kërkojnë nga Gjykata të nxjerrë vendim me të cilin:

“VËRTETOHET SE Ligji për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës nuk është miratuar në pajtim me nenin 81 të Kushtetutës së Kosovës, prandaj deklarohet JOKUSHTETUES dhe shfuqizohet.

Krahësim me sa më sipër, meqenëse aplikimi i këtij ligji në këtë formë mund t'i shkaktojë potencialisht dëme të pariparueshme komunitetit serb në Kosovë, dhe për moszbatimin e tij deri në marrjen e vendimit përfundimtar për kushtetutshmërinë e ligjit, i propozojmë Gjykatës Kushtetuese që të caktojë këtë:

MASË TË PËRKOHSHME

SUSPENDOHET vlefshmëria e Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës deri në marrjen e vendimit përfundimtar për kushtetutshmërinë e Ligjit”.

Komentet e Grupit parlamentar të LVV-së

28. Më 6 korrik 2016, Gjykata pranoi komentet e Grupit parlamentar të LVV-së, ku, ndër të tjera, argumentohet:

“Pretendimi për shkelje të nenit 81 të Kushtetutës është i pabazuar dhe ka tendencë që të themelojë një të drejtë kushtetuese me karakter të kontrollit parlamentar të brendshëm në drejtim të njohjes së institutit të shumicës së dyfishtë, pa asnjë bazë të normativitetit kushtetues”.

Sipas nenit 81 të Kushtetutës, “për ligje që janë cilësuar me karakter të veçantë nevojitet dyfishi i shumicës së thjeshtë të deputetëve që përmbushin kuorumin dhe shumicës së thjeshtë të deputetëve që mbajnë vende të garantuara në Kuvendin e Kosovës. Sigurisht që për t'u konstatuar se kur vjen në shprehje zbatimi i një çelësi të tillë procedural në kuptimin e së drejtës administrative parlamentare, duhet vazhduar leximin e dispozitës me nënparagrafët të cilët sipas parimit të numërimit taksativ përcaktojnë ligjet nga fushat e përcaktuara, për të cilët për ndryshimin, plotësimin apo shfuqizimin e tyre kërkohet procedurë e veçantë e miratimit të nismës së caktuar legjislative e cila afekton ligjet që janë përcaktuar me këtë dispozitë”.

29. Për më tepër, në komente argumentohet:

“... Meqenëse emërtimi i dispozitës (neni 81 i Kushtetutës) përfshin termin legjislacion, nënkuptohet se nuk kemi të bëjmë me aktet që përcaktohen me emërtim konkret. Por termi legjislacion nënkupton grupin e disa akteve ligjore e që përbëjnë një pjesë të legjislacionit që është në fuqi”.

Argumentet shtesë, të dorëzuara nga parashtruesit pas dorëzimit të kërkesës

30. Më 11 korrik 2016, parashtruesit dorëzuan komente shtesë, duke pretenduar shkelje të Rregullores së Kuvendit, për faktin se komisioni funksional nuk i ka respektuar afatet kohore për dorëzimin e raportit final në Kuvend, përkthazi me Projektligjin për AKKVP-në.
31. Në lidhje me këtë, parashtruesit theksojnë:

“Me nenin 57 pika 1 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, është paraparë si në vijim: ‘Pas miratimit të projektligjit në shqyrtim të parë, Kuvendi i ngarkon për shqyrtim të mëtejshëm: Komisionin funksional, si komision raportues dhe komisionet: për Legjislacion dhe Gjyqësi, për Buxhet e Financa, për Integritet Evropian, për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Komisioni për të Drejtat e Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, si komisione të përhershme’.

Me pikën 6 të nenit të njëjtë është parashikuar se: ‘Komisioni funksional Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandime për projektligjin brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë’.

Duke pasur parasysh të gjitha të lartcekurat, ju informojmë se afatet ligjore për miratimin e ligjit janë shkelur për shkak se ligji në lexim të parë është miratuar më 7 prill 2015, ndërsa për miratimin e dytë të ligjit është pritur deri më 9 qershor 2016, që paraqet periudhën prej 1 viti dhe dy muaj’.

32. Më tutje, parashtruesit ua kanë bashkëngjitur komenteve shtesë shkresën e 28 qershorit 2016, me të cilën i janë drejtuar Drejtorit të Drejtorisë për Mbështetje të Komisioneve Parlamentare dhe e kanë informuar për mbledhjen e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, të mbajtur më 8 qershor 2016. Komisioni në këtë datë e kishte shqyrtuar raportin e Komisionit funksional të Projektligjit për AKKVP-në, dhe kishte vlerësuar se dispozitat e Projektligjit cenojnë interesat dhe të drejtat e komuniteteve dhe, se i njëjti nuk rregullon në mënyrë adekuate çështjen e komuniteteve. Në pikën e pestë të kësaj shkrese thuhet: “... Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nuk e ka proceduar raportin me rekomandime të Projektligjit nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës për shqyrtim të dytë në Seancën Plenare (2 vota për dhe 7 kundër)”.

Pranueshmëria e kërkesës

33. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesve, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
34. Fillimisht, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, që përcakton se “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

35. Më tej, Gjykata vëren se kërkesa është parashtruar në bazë të nenit 113, paragrafi 5, të Kushtetutës. Kjo dispozitë kushtetuese përcakton:

“Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur”.

36. Në rastin konkret, Gjykata verën se kërkesa është parashtruar nga 11 deputetë të Kuvendit, si dhe brenda afatit ligjor prej 8 (tetë) ditësh nga dita e miratimit të Ligjit për AKKVP-në. Rrjedhimisht, kërkesa plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 113, paragrafi 5, lidhur me palët e autorizuar dhe afatin kohor për paraqitjen e një kërkesë të tillë.
37. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh nenin 42 të Ligjit që rregullon parashtrimin e kërkesës në bazë të nenit 113.5 të Kushtetutës, i cili parasheh si vijon:

Neni 42 Saktësimi i kërkesës

“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 (do duhej të ishte paragrafi 5) të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti”.

38. Gjykata vlerëson se kërkesat nga neni 42 i Ligjit janë plotësuar, sa i përket emrave dhe nënshkrimeve të deputetëve, specifikimit të ligjit të kontestuar dhe dispozitave relevante të Kushtetutës që ndërlidhen me procedurën e ndjekur gjatë votimit dhe miratimit të Ligjit në Kuvend.
39. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(...)

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(...)

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

40. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se miratimi i Ligjit për AKKVP-në, me procedurë të zakonshme nga Kuvendi (siç e rregullon neni 80), shkel të drejtat dhe interesat e komunitetit serb në Republikën e Kosovës dhe se i njëjti është

miratuar në kundërshtim me nenin 81 të Kushtetutës, për arsye se ky ligj ishte me interes vital për këtë komunitet.

41. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht vë në pah se kompetencat e Kuvendit janë të përcaktuara me nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës, prej të cilave, për rastin konkret, relevante është vetëm fjalia e parë e paragrafit 1 të këtij neni, që përcakton:

“Kuvendi i Republikës së Kosovës:

(1) Miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme”.

42. Më tej, neni 69 [Orari i Seancave dhe Kuorumi] përcakton:

“(3) Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve të Kuvendit”.

43. Për sa i përket miratimit të ligjeve të zakonshme, Kushtetuta, në nenin 80, ka përcaktuar, si në vijim:

Neni 80 [Miratimi i Ligjeve]

“1. Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.

44. Me këtë nen, Kushtetuta përcakton procedurat që duhet të ndiqen nga momenti i votimit dhe miratimit të Ligjit deri te shpallja dhe hyrja e tij në fuqi. Miratimi i ligjeve, sipas kuptimit të paragrafit 1, të nenit 80, kërkon shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, siç edhe ka ndodhur në rastin konkret.
45. Për sa i përket miratimit të ligjeve me interes vital, Kushtetuta, në nenin 81 ka përcaktuar, si në vijim:

Neni 81* [Legjislacioni me Interes Vital]

“1. Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, si dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë, të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e Komuniteteve që nuk janë shumicë:

(1) ligjet të cilat ndryshojnë kufijtë e komunave, themelojnë ose shuajnë komuna, përkufizojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale dhe tejkufitare;

(2) ligjet të cilat zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara me Kushtetutë;

(3) ligjet për përdorimin e gjuhëve;

(4) ligjet për zgjedhjet lokale;

(5) ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;

(6) ligjet për liritë fetare ose për marrëveshjet me komunitetet fetare;

(7) ligjet për arsimin;

(8) ligjet për përdorimin e simboleve, përfshirë simbolet e komuniteteve dhe për festat publike.

2. Asnjëri nga ligjet me interes vital, nuk mund t'i nënshtrohet referendumit”.

46. Siç vërehet më sipër, neni 81 i Kushtetutës në mënyrë taksative i numëron ligjet me interes vital për Republikën e Kosovës, miratimi i të cilëve kërkon votat e shumicës së deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, si dhe votat e shumicës së deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara nga komuniteti joshumicë.
47. Parashtruesit argumentojnë se Ligji për AKKVP-në është i interesit vital për komunitetin serb, duke potencuar, ndër të tjera, se: Ligji është rezultat i marrëveshjeve të arritura në dialogun e organizuar në Bruksel ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë; se shumica dërmuese e kërkesave pronësore të paraqitura para Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), e cila është paraardhëse e AKKVP-së, janë paraqitur nga persona të zhvendosur në Serbi dhe Mal të Zi, përkatësisht nga serb dhe jo-shqiptarë dhe se *“ekziston frika se do ketë falsifikime masive nëse dokumentacioni kadastral në bazë të Marrëveshjes për Kadastrën, bartet në Kosovë”*.
48. Përkritazi me këto pretendime, Gjykata konsideron se argumentet dhe interpretimet e mësipërme nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për të mbështetur pretendimin e parashtruesve, se Ligji për AKKVP-në është me interes vital për një komunitet të caktuar etnik në Kosovë dhe jo me interes të njëjtë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.
49. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesit nuk arrijnë të argumentojnë mjaftueshëm pretendimin e tyre se, me rastin e miratimit të Ligjit për AKKVP-në, Kuvendi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 81 të Kushtetutës.
50. Gjykata vëren se si argument plotësues parashtruesit i referohen faktit se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve nuk ka mbështetur, në parim, miratimin e Projektligjit për AKKVP-në.
51. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata konsideron se parashtruesit nuk elaborojnë pretendimin se mosrekomandimi i miratimit të Projektligjit për AKKVP-në, nga ana e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, ka rezultuar në shkelje kushtetuese me rastin e miratimit të Ligjit për AKKVP-në. Për më tepër, Gjykata vëren se, lidhur me këtë pretendim, parashtruesit kanë paraqitur si provë një shkresë të datës 28 qershor 2016, me të cilën ata kanë njoftuar Kuvendin, respektivisht Drejtorin e Drejtorisë për Mbështetje të Komisioneve Parlamentare, që Komisioni në fjalë nuk e mbështeti Projektligjin për AKKVP-në. Kjo do të thotë se shkresa në fjalë, të cilës i referohen parashtruesit, është dërguar pasi që Ligji për AKKVP-në u debatua në Kuvend nga të gjitha grupet parlamentare dhe u miratua e madje edhe pas dorëzimit të kërkesës së parashtruesve në Gjykatë.
52. Më tej, Gjykata vëren se në argumentet shtesë, të dorëzuara më 11 korrik 2016, parashtruesit ngrenë pretendimin plotësues se Komisioni për Legjislacion, si

komision funksional, nuk i ka respektuar afatet ligjore prej 2 (dy) muajsh për dorëzimin e raportit në Kuvend, nga momenti i shqyrtimit të parë.

53. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se parashtruesit nuk argumentojnë se pretendimi në fjalë, që ka të bëjë me Rregulloren e Kuvendit, paraqet shkelje kushtetuese, të cilat Gjykata do të kishte kompetencë që t'i shqyrtonte.
54. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i mbështesin mjaftueshëm pretendimet e tyre për shkelje kushtetuese gjatë miratimit në Kuvend të Ligjit për AKKVP-në.
55. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

56. Sa i përket kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme, Gjykata vëren se parashtruesit kërkojnë nga Gjykata të pezullojë zbatimin e ligjit në fjalë, derisa e njëjta të vendosë përfundimisht për kërkesën.
57. Sa i përket kësaj kërkesë, Gjykata i referohet nenit 43, paragrafi 2, të Ligjit që parasheh:

"2. Në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendimi i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar."

58. Gjykata rithekson se ligji i kontestuar nuk hyn në fuqi dhe nuk do të implementohet, si dhe ai do t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje pas vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese. Rrjedhimisht, kërkesa për masë të përkohshme nuk është e aplikueshme.
59. Rrjedhimisht, Gjykata e refuzon kërkesën për masë të përkohshme si të paaplikueshme dhe si, të tillë, të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.5 të Kushtetutës, në mbështetje të nenit 20, 42 dhe 43 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullave 36 (1) (d), 36 (2) (d) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 25 tetor 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën e parashtruesve për masë të përkohshme, si të paaplikueshme në bazë të nenit 43.2 të Ligjit;
- III. TË SHPALLË që Ligji nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje;
- IV. T'UA KUMTOJË këtë vendim parashtruesve të kërkesës, Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;
- V. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi